



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA IV**

**Sesioni IV**

**Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim  
Mbledhja nr. 03.**

**Prishtinë, më 19.04.2011 ora 13:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-323**

**PROCESVERBAL**

**I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim**

**Në mbledhje morën pjesë:** Saša Rašić, Myzejene Selmani, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi Agim Kuleta, Jasmina Živković, Jelena Bontić, Petar Miletić, Rasim Demiri dhe Etem Arifi

**Mungon:** Mufera Sinik.

**Emrat e pjesëmarrësve të tjerë:** përfaqësues nga OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesi nga Ambasada Zvicrane Sakibe **Jashari** dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

**Emrat e stafit mbështetës të komisionit:** Drita Çarkaxhiu.

**Mbledhjen e kryesoi:** Saša Rašić, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**
- 3. Ndryshim dhe plotësim i Draft - planit dhe programit të punës për vitin 2011.**
- 4. Të ndryshme**

**Kryesuesi** - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar 30.03.2011**

**Kryesuesi** – konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30.03.2011, pa vërejtje.

### 3. Ndryshim dhe plotësim i Draft - planit dhe programit të punës për vitin 2011.

**Kryesuesi** – në fjalinë e tij tha se në mbledhjen e kaluar, Komisioni ka miratuar në parim Planin e Punës për vitin 2011. Sotë do të diskutohet lidhur me zhvillimet legjislative të Qeverisë dhe propozimet për vizita në teren dhe jashte vendit.

Ai theksoi se në bazë të planit të veprimit, i cili është ndihmuar nga zyra e OSBE-së, do të mabehet një puntori pune një ditore, më 27.04.2011 në Restroant 'Puro' në Prishtin dhe se në bazë të përmbledhjes së informatave do të plotësohet dhe ndryshohet plani i punës për vitin 2011.

Fllimisht, ai do të bëjë hapjen e seminarit, pastaj do të prezantoj z, Petar Miletic, për sfidat dhe aktivitetet e komisionit për mandatin e tretë.

Për gjendjen dhe sfidat e komuniteteve në Kosovë do të prezantojnë anëtarët e komisionit: në emër të komunitetit shqiptar znj. Myzejene Selmani, komunitetit serb Znj. Jasmina Zivkovic, komunitetit boshnjak, Z.Rasim Demiri, komunitetit turk, Znj Mufera Sinik, dhe të komunitetit rom, Z.Albert Kinolli.

Propozoi që për gjendjen dhe sfidat e komuniteteve pakicë ne Kosove do të prezantojnë. Danush Ademi, Xhevdet Neziraj dhe Mursel Haljili.

Ai shtoi se Komisioni do të ftojë dy zëvendës kryesues të Këshillit Konsultativ për Komunitete pran zyrës së **Presidencës**; z, Kujtim Paçaku dhe Qerim Bajrami, ku do të prezantojnë për punën e veprimtarisë të Këshilli Konsultativ për Komunitete dhe për sfidat dhe planet që kanë për vitin 2011. Njëkohësisht do të ftojë një përfaqësues nga Ministria për Komunitete dhe Kthim ku do të prezanton planin vjetor dhe ndarjen e buxhetit për vitin 2010, 2011 dhe 2012 dhe z. Srdjan Sentic drejtorin e zyrës për Çështje të Komuniteteve, pran zyrës së Kryeministrit i cili do të prezantoj prioritetet e përcaktuara sipas autoritetit të kësaj zyre, për vitin 2011.

**Kryesusei**- theksoi se për hartim të planit të punës njëvjeçare të Komisionit, do të bazohemi në Strategjin legjislative të Qeverisë dhe në Planin e veprimit të Kuventit të Kosovës për Integritet Evropiane për vitin 2011.

Lidhur me këto pika, unanimisht u pajtuan anëtarët e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30

**Përgatitur nga:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Saša Rašić**